



REPublika e Kosovës/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 03-02/DPK	Br. Prot. 01-73/16
Nr. l faq.	Prot No.
Broj stranica	Data
Nr. pages 02	Datum 12-01-2016
PRISHTINË	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.01.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4306/15, për zyrtarin e lartë z. Kadri Emini, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal Shtime, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të mundshëm të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4306/15, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Kadri Emini, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Shtimes .**

Gjatë kontrollit për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit është identifikuar rasti i z. Kadri Emini i cili ka një biznes privat dhe është person i autorizuar ne ketë biznes, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.11.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Kadri Emini ka ardhur ne takim me zyrtaret e AKK-së, ku nga ta është njoftuar me faktet dhe me gjendjen në të cilën gjendet.

Zyrtari i lartë z. Emini gjate takimit është pajtuar me gjendjen por është arsyetuar se nuk ka pasur njohuri se çështja e ngritur nga AKK-ja, është ne kundërshtim me ligjin ne fuqi, por është zotuar se brenda afatit ligjore do ta bej ndryshimin dhe do te largohet nga pozita e personit të autorizuar në këtë biznes .

Agjencia kundër Korrupsionit pasi qe ka vërejtur se zyrtari ne fjalë nuk i ka sjell ndryshimet në biznes i ka ber shkresën e dytë paralajmëruese dhe e ka paralajmëruar qe nëse brenda afatit të paraparë nuk ndërmerrni hapat për ta shmangur konfliktin e interesit Agjencia do te veproj konform nenit 18.8 të Ligjit Nr.04/L-051.

Me datën 08.01.2016 kemi pranuar dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë z Kadri Emini, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Shtimes, nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin D.P.Z “DIMI” me numër 71124061.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Kadri Emini, Këshilltar Komunal ne Kuvendin Komunal të Shtimes, dukë bërë ndryshimet në biznesin ku ka vepruar si person i autorizuar, është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues )

Hasan Preteni  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

